



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:101087

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06580167

**C.nr.282/2023**

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, Gjyqtari Nexhat Aliu , në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. me seli Bulevardi Bill Clinton”nr.5 ne Prishtinë, kundër të paditurit A.I.nga fshati B. K.Viti , baza e kontestit, kompenzim e dëmit material, vlera e kontestit 636.21 Euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 10.12.2024 , bie këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Për shkak të padëgjueshmërisë /mosbindjes/**

**I. APROVOHET** kërkespacia e paditëses Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. me seli Bulevardi Bill Clinton”nr.5 ne Prishtinë, dhe **DETYROHET** i padituri A.I.nga fshati B. K.Viti , që paditëses të ja paguaj dëmin material në shumë prej 636.21 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë nga paditësja me datë 04.05.2023 , si dhe shpenzimet e procedurës per takes gjyqësore ne shume prej 20 Euro.

E gjithë këto në afat 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. me seli Bulevardi Bill Clinton”nr.5 ne Prishtinë, ka ushtruar padi në këtë gjykata me dt. 04.05.2023. kundër të paditurit A.I.nga fshati B. K.Viti baza e kontestit, kompenzimin e dëmit material, në vlerë prej 636.21 Euro .

Gjykata të paditurit A.I.konform dispozitave te LPK-së, me datën 23.07.2024 , ia ka dorëzuar padinë në përgjigjeje, por nuk iu kishte bindur aktvendimit per përgjigjeje në padi.

Pasi që i padituri nuk ka paraqitur fare përgjigjeje ne padi, Gjykata duke aplikuar nenin 150, paragrafi 1 pika a dhe b, të LPK-se, lidhur me nenin 388, të LPK-se, bie Aktgjykim, për shkak të pa dëgjueshmërisë- mosbindjes së të paditurit

Andaj Gjykata vendosi si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI**  
**C.nr.282 /2023**  
Më: 10.12.2024

**Gjyqtari**  
Nexhat Aliu

**UDHËIM PËR MJETIN JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.